



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 12.01.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-4318/22, për zyrtarin e lartë z. Driton Maliqaj, Zëvendës Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Rexhep Kuçi” në Komunën e Suharekës, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.**


A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Driton Maliqaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatave nga raportuesit e jashtëm, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit sipas të cilit z. Driton Maliqaj, si anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, njëkohësisht është zgjedhur edhe si zv. Drejtor në Qendrën Klinike të Mjekësisë Familjare “Rexhep Kuçi” në Suharekë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-02/4435/22), dhe me të njëjtin është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë.

Në takimin e mbajtur, zyrtari i lartë është njoftuar lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe me faktet që posedon Agjencia përkitazi me kufizimet sa i përket mbajtjes së njëkohshme të dy pozitave të lartcekura, dhe atë duke ju referuar Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (neni 65 paragrafi 2), si dhe janë dëgjuar arsyetimet e z. Maliqaj lidhur



me pretendimet e ngritura, i cili ndër të tjerat ka konfirmuar mbajtjen e të dy pozitave dhe ka theksuar se mbajtja e njëkohshëm e tyre nuk është në kundërshtim me ligjin, pasi që ndalesa në fjalë vlen vetëm për drejtorët e institucioneve vartëse të komunës.

Në vazhden e sqarimeve, Agjencia e ka njoftuar zyrtarin e lartë se paragrafi 2, neni 65 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton se:

“Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të kuvendit të Republikës së Kosovës apo kuvendit të komunës të komunës ku ata punojnë”.

Ndërsa sa i përket pozitës së zëvendës drejtorëve të institucioneve përkatëse, Agjencia e ka njoftuar zyrtarin se dispozita e paragrafit 2 të nenin 65 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, që flet për drejtorët komunal dhe drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës, nënkupton edhe zëvendësdrejtorët e institucioneve përkatës.¹

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-02/4435-1/22) me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. dhe 1.4. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Maliqaj, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit/papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshka
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit
APK
AGJENCIA PËR SPREÇAVANJE KORRUPSIONIT
REPUBLIC OF KOSOVO

¹ Interpretimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas kërkesës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (DPKI-06-4954/22).